

**LIGJI Nr. 04/L-111
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

Neni 1

Pas nenit 1 të ligjit bazik shtohet nen i ri me emërtimin dhe përmbajtjen si vijon:

**Neni 1.A
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, shpallur në Gazetën Zyrtare nr.31, (15 qershor 2008).

Neni 2

1. Neni 2 i ligjit bazik përkufizimi **“Ministri”** ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

“Ministri” - nënkupton Ministrin e Ministrisë përkatëse për Zhvillim Ekonomik, dhe ky ndryshim vlen për tërë tekstin e ligjit bazik

2. Neni 2 i ligjit bazik përkufizimi **“Ministria”** ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

“Ministria” - nënkupton Ministria përkatëse për Zhvillim Ekonomik.

3. Neni 2 i ligjit bazik, pas përkufizimit **“Aksionar”** shtohen dy përkufizime të reja me tekstin si në vijim:

“Zyrtar i zgjedhur publik” - nënkupton individin i cili e ushtron një post publik, të cilin e ka fituar përmes zgjedhjeve.

“I emëruar politik” - nënkupton personin i cili është emëruar, ose propozuar nga subjekti politik si kandidat për një post të zgjedhur.

Neni 3

Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 5.1. në pjesën e dytë të paragrafit, pas fjalisë **“Komisioni i zgjedhur gjithnjë duhet të përfshijë...”**, fshihet **“Ministrin e Ekonomisë dhe Financave”** dhe zëvendësohet me tekstin **“Ministrin përkatës për Zhvillim Ekonomik”**, fshihet **“Ministrin e Energjisë dhe Minierave”** dhe zëvendësohet me **“Ministrin përkatës për Financa”**, fshihet **“Ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit”** dhe zëvendësohet me **“Ministrin e Infrastrukturës”**.

Neni 4

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.1 riformulohet si në vijim:

7.1. Aksionari(ët) e një NP nëpërmjet Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.4. pas fjalisë: “Kurdo që është e nevojshme, Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP do të kërkojë dorëzimin e të dhënave më specifike” shtohet togfjalëshi “nga menaxhmenti”.

3. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.5. riformulohet me tekstin si në vijim:

7.5. Komunikimi ndërmjet Aksionarit(ëve) ose Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve dhe Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit të një NP-je rregullisht do të kanalizohet përmes kryesuesit, sipas rastit, Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit, ndërsa me qëllim të informimit dhe mbikëqyrjes, Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve komunikon drejtpërdrejt edhe me zyrtaret e lartë të NP.

Neni 5

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 9.2. pika (i) fshihet emërtimi “Ministri i Ekonomisë dhe Financave” dhe zëvendësohet me tekstin “Ministri i Ministrisë përkatëse për Zhvillim Ekonomik”.

2. Neni 9 i ligjit bazik paragrafi 9.3. riformulohet me tekstin si në vijim:

9.3. Komisioni Qeveritar për Privatizim mbështetet nga një Njësi Implementuese e Privatizimit, e cila do të themelohet për këtë qëllim nga Ministri në kuadër të Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve në Ministrinë përkatëse për Zhvillim Ekonomik. Njësia Implementuese e Privatizimit i përgjigjet drejtpërdrejt Komitetit Qeveritar për Privatizim dhe ajo do të përfshijë ose të përkrahë nga këshilltarë të jashtëm profesional të cilët Komisioni Qeveritar i Privatizimit i konsideron të nevojshëm.

Neni 6

Neni 11 i ligjit bazik, pas nën-paragrafit 11.2, shtohet një nën-paragraf i ri 11.3. me tekstin si në vijim:

11.3. Komunitetët kanë të drejtën për të krijuar ndërmarrje publike lokale në pajtim me kriteret e përcaktuara me akt nën-ligjor të Qeverisë. Kriteret duhet të përshijnë kërkesa të arsyeshme për qëndrueshmëri operacionale dhe financiare.

Neni 7

Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi 14.3. në pjesën e dytë të paragrafit pas fjalisë “NP duhet të përgatisë dhe” i shtohet fjalia “pas auditimit të jashtëm të”.

Neni 8

1. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 15.1. riformulohet si në vijim:

15.1. Bordi i Drejtorëve të një NP Qendrore do të përbëhet nga pesë (5) ose shtatë (7) drejtorë, ku një (1) nga ata duhet të jetë nga komuniteti jo shumicë. Të gjithë drejtorët, përveç njërit, do të zgjidhen nga Qeveria dhe secili drejtor i zgjedhur në këtë mënyrë shërben me mandat prej tri (3) viteve. Drejtori tjetër do të jetë KE i NP-së dhe zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të këtij ligji. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve të bordit të drejtorëve të një NP Qendrore, Qeveria mund të zgjedhë vetëm personat të cilët i janë rekomanduar Qeverisë nga Komisioni përkatës Rekomandues i themeluar në përputhje me paragrafin 2. të këtij neni. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve, Qeveria duhet të sigurojë që nga lista

rekomanduese së paku dy (2) drejtorë të jenë ekspertë, ose së paku të kenë njohuri adekuate, të kontabilitetit, siç kërkohet nga neni 17.4 i Ligjit Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike.

2. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 15.13. shtohet një paragraf i ri 15.14. me tekstin si në vijim:

15.14. Pjesëmarrja e komunave në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit:

a) në Bordet e Drejtoreve të secilës ndërmarrje rajonale të ujit, Qeveria duhet të emërojë të paktën gjysmën e drejtoreve nga kandidatet e nominuar nga komunat ku ofron shërbimet ndërmarrja rajonale e ujit.

b) komunat përkatëse duhet t'i dorëzojnë Qeverisë një numër kandidatësh të cilët i përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj, numër i cili duhet të jete të paktën tre (3) me shume se sa numri i pozitave të hapura për drejtor të rezervuar për përfaqësues të komunave.

c) nëse komunat përkatëse nuk nominojnë një numër të mjaftueshëm të kandidateve të përshtatshëm për të shërbyer si Drejtor, komunat do të kenë një rast shtesë që pas gjashtë (6) muajve të dorëzojnë emra të ri të kandidateve të përshtatshëm. Në ndërkohë, Qeveria mund të emërojë për kohësisht një Drejtor të kualifikuar.

d) nëse komunat nuk nominojnë kandidate të përshtatshëm për zgjedhje brenda afatit shtesë prej gjashtë (6) muajve, Qeveria emëron Drejtorin e kualifikuar që të shërbej për pjesën e mbetur të mandatit.

e) procedura e nominimit dhe zgjedhjes së kandidateve të komunave duhet të përcaktohet në një akt nën-ligjor të lëshuar në pajtim me këtë ligj.

Neni 9

Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 17.1. pas pikës (d) shtohet edhe një pikë e re (e) si në vijim:

(e) nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

Neni 10

1. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 18.1. në fund të paragrafit pas fjalisë "të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së" shtohet në vazhdim fjalia "por kjo nuk nënkupton edhe përzjerjen në mikromenaxhim".

2. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 18.3. pika (i) riformulohet si në vijim:

(i) Qeverisë, përmes Njesisë për Politika dhe Monitorim të NP, për NP-të Qendrore, ose

Neni 11

Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 19.2 riformulohet si në vijim:

19.2. Nëse Aksionari(ët) përmes Njesisë për Politikat dhe Monitorimin e NP-ve konstatojnë se shkelja në fakt ka ndodhur, Aksionari(ët) (i) pas rekomandimit të Njesisë për Politikat dhe Monitorimin e NP-ve menjëherë do ta shkarkojë dhe zëvendësojë drejtorin ose drejtorët përgjegjës dhe (ii) NP menjëherë duhet të kërkojë masa ligjore kundër drejtorëve të cilët kanë bërë shkeljen kurdo që provat në dispozicion me arsye supozohet se janë të mjaftueshme për ngritjen e suksesshme të një padie për kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar NP-së nga shkelja; megjithatë, NP nuk është e detyruar që të paraqesë padi kundër drejtorit(ëve) të cilët kanë bërë shkeljen nëse me arsye ka gjasa se shumica e kompensimit e cila mund të fitohet do

të jetë më e ulët se shpenzimet të cilat me arsye pritet se do t'i ketë NP-ja gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore.”

Neni 12

1. Neni 20 i ligjit bazik, paragrafi 20.5. pika (iii) riformulohet si në vijim:

(iii) ta kufizojë kompensimin për stimulimin e përfomancës vjetore (nëse ka) e që përcaktohet pas auditimit të pasqyrave financiare dhe publikimit të raporteve mbi përfomancën nga zyrat rregullatorë. Ky kompensim-bonus u paguhet drejtorëve, në një shumë deri në pesëdhjetë përqind (50%) e honorarit themelor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

2. Neni 20 i ligjit bazik, paragrafi 20.6 riformulohet si në vijim:

20.6. NP është përgjegjëse për pagimin e të gjithë kompensimit për drejtorët e saj vetëm nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit. Drejtorët e NP nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP.

Neni 13

Neni 21 i ligjit bazik, paragrafi 21.4. riformulohet si në vijim;

21.4. Për përzgjedhjen e personave për emërim si zyrtarë të NP-së, Bordi i Drejtorëve duhet të kryejë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, e cila ka për qëllim që të gjitha emërimet të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë personat e emëruar si zyrtarë të jenë persona me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; me kusht që (i) Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit; (ii) Këshilltari i Përgjithshëm / Sekretari i Korporatës të posedojë diplomë universitare në ligj dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare; dhe (iii) Zyrtari për Auditim të Brendshëm të jetë person ekspert i certifikuar në kontabilitet.

Neni 14

1. Neni 24 i ligjit bazik paragrafi 24.1. riformulohet si në vijim:

24.1. Çdo Komision i Auditimit do të përbëhet nga tre (3) drejtorë të zgjedhur. Komisioni i Auditimit dhe Kryesuesi caktohet nga Ministri. Së paku dy (2) anëtarë të caktuar në këtë mënyrë duhet të jenë drejtorë të cilët janë ekspertë, ose së paku kanë njohuri adekuate në kontabilitet. Anëtari i tretë do të jetë një drejtor tjetër, përveç KE-së ose kryesuesit.”

2. Neni 24 i ligjit bazik, paragrafi 24.3. fshihet në tërësi.

Neni 15

Neni 28 i ligjit bazik, paragrafi 28.2 pika (ii) riformulohet si në vijim:

(ii) anëtarëve të Komisionit(eve) Komunal të Aksionarëve për NP Lokale me se largu deri me 30 maj të vitit përkatës.

Neni 16

Neni 29 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin në vijim:

Nën përgjegjësinë e KE-së, NP rregullisht do të testojë kënaqësinë e konsumatorëve me shërbimet të cilat i ofron. Ndërmarrja do të miratojë procedurat përkatëse dhe do të nxjerrë një raport të thjeshtë, i cili paraqet nivelin e kënaqësisë së konsumatorëve, si dhe vërejtjet e KE-së lidhur me çdo ndryshim të këtij niveli. Ky raport i dorëzohet (i) Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve më së largu deri me 31 mars për vitin paraprak, e cila e publikon atë në faqen e saj në internet dhe (ii) sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit(eve) përkatës Komunal të Aksionarëve.

Neni 17

Neni 30 i ligjit bazik, paragrafi 30.1. pjesa e parë e paragrafit ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

30.1. Deri me 31 Tetor të çdo viti kalendarik, zyrtarët e secilës NP duhet të përgatisin Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik në pajtueshmëri me politikën zhvillimore të sektorit që i bën Ministria e Linjës dhe në përputhshmëri me Planin zhvillimor komunal. Ky plan duhet që së pari t'i dorëzohet për miratim Bordit të Drejtorëve. Pas miratimit, Plani Afarist i dorëzohet, për qëllime të informimit vetëm, sipas rastit, Ministrin ose Komisionit(eve) përkatës Komunal të Aksionarëve. Plani i Biznesit mund të rishikohet pas gjashtëmuajorit të parë të vitit. Plani Afarist duhet të analizohet së paku, si vijon:

Neni 18

Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 31.5. i shtohet paragrafi i ri 31.6. si në vijim:

31.6. Raportet Vjetore dhe Tremujore në formë të informatës i dërgohen edhe Kryetarit të Komunës në të cilën e ushtron veprimtarinë Ndërmarrja Publike, në pajtim me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 19

1. Neni 33 i ligjit bazik paragrafi 33.1. riformulohet si në vijim:

33.1. Pasqyrat Vjetore Financiare të çdo Ndërmarrje Publike i nënshtrohen një auditimi të jashtëm të paraparë me ligj në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare të auditimit. Ky auditim kryhet nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar. Produkti përfundimtar i një auditimi të tillë duhet të jetë një opinion mbi vërtetësinë për Pasqyrat Vjetore Financiare përfshirë këtu edhe Letër Menaxhmentin. Opinioni dhe Letra e Menaxhmentit duhet të dorëzohen tek Njësia e Politikave dhe Monitorim të NP-ve më së largu deri më 30 maj të vitit vijues për vitin paraprak. Përveç kësaj, Auditori i Përgjithshëm, Qeveria dhe Kuvendi mund të kryejnë çfarëdo lloj auditimi që konsiderojnë se është i nevojshëm.

2. Neni 33 i ligjit bazik, paragrafi 33.3. riformulohet si në vijim:

33.3. Auditimin e Pasqyrave Financiare do ta bëjë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në të kundërtën, Zyrtari i Prokurimit i NP-së do të prokurorë shërbimet e një auditori për kryerjen e auditimit të jashtëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik dhe me nenin 33 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Kontrata përkatëse do të ketë kohëzgjatje prej tri (3) viteve.

Neni 20

Neni 34 i ligjit bazik, paragrafi 34.1. riformulohet si në vijim:

34.1. Të gjitha NP do t'i përgatisin dhe vënë në fuqi rregulloret të cilat kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Miratimi, ndryshimi, plotësimi, si dhe shfuqizimi i Rregulloreve të NP-ve është kompetencë ekskluzive e Bordit të Drejtorëve të NP-së; megjithatë, Aksionari(ët) e NP-së duhet të sigurojë që rregulloret të jenë në përputhje me këtë Ligj dhe modelet e rregulloreve të shpallura nga Ministri sipas paragrafit 4 të nenit 34 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Neni 21

Në nenin 39, të ligjit bazik, paragrafi 39.1, emërtimi “Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave” fshihet dhe zëvendësohet me emërtimin “Ministrinë përkatëse për Zhvillim Ekonomik”.

Neni 22

Neni 43 i ligjit bazik, paragrafi 43.1. riformulohet si në vijim:

43.1. Qeveria është e autorizuar që ta emërojë një Bord të Përkohshëm të Drejtorëve (“Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve”) për secilën NP për të shërbyer në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar me miratimin e Vendimit mbi Themelimin e një Ndërmarrje Publike të re apo nga shkarkimi i bordit aktual deri në përzgjedhjen e bordit të përhershëm në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Neni 23

1. Lista 1 Ndërmarrjet Publike Qendrore në ligjin bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

Lista 1

Ndërmarrjet Publike Qendrore

1. Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.A (KEK);
2. Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim të Energjisë(KKDFE);
3. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, sh.A (KOSTT);
4. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.A (PTK);
5. Hekurudhat e Kosovës-TrainKos sh.A;
6. Hekurudhat e Kosovës-InfraKos sh.A;
7. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës-Kontrolli Ajror”Adem Jashari” sh.A;
8. Kompania për Menaxhimin e Deponive sh.A;
9. NPH Iber Lepenc Sh.A.

Kompanitë Rajonale të Ujitjes:

1. Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë sh.A Pejë.
2. Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini sh.A Gjakovë.

Kompanitë Rajonale të Ujësllësit:

1. Kompania Rajonale e Ujësjetës Prishtina sh.A, Prishtinë;
2. Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidrodrini sh.A, Pejë;
3. Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh.A, Prizren;
4. Kompania Rajonale e Ujësjetës Mitrovica sh.A, Mitrovicë;
5. Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidromorava sh.A, Gjilan;
6. Kompania Rajonale e Ujësjetës Radoniqi sh.A, Gjakovë.
7. Lista 2 Ndërmarrjet Publike Lokale në Ligjin në fuqi fshihet dhe riformulohet si ne vijim:

Lista 2

1. Ngrohja e Qytetit Termokos sh.A, Prishtinë, Prishtina 100%;
2. Ngrohja e Qytetit Gjakova sh.A, Gjakovë, Gjakova 100%;
3. Kompania Rajonale e Mbeturave Çabrat sh.A Gjakovë , Gjakova 100%;
4. Kompania e Mbeturave JKP Standard, Mitrovicë, Mitrovica 100%;
5. Kompania e Mbeturave JKSP Zveçan, Zveçan, Zveçani 100%;
6. Kompania e Ujësjetës dhe Mbeturave Ibri, Zubin Potok, Zubin Potoku 100%;
7. Kompania e Ujësjetës dhe Mbeturave 24 Nëntori, Leposaviq ,Leposaviqi 100%;
8. Kompania Rajonale e Ujësjetës Bifurkacioni sh.A, Ferizaj:
 - 8.1. Njësia Operative Ferizaj, Ferizaj 85.3% ;
 - 8.2. Njësia Operative Kaçanik, Kaçaniku 14.7%.
9. Ndërmarrja Publike Banesore, Prishtinë , Prishtina 100%;
10. NP Tregu, Mitrovicë, Mitrovica 100%;
11. Kompania Rajonale e Mbeturave Pastrimi sh.A, Prishtinë;
12. Kompania Rajonale e Mbeturave Ambienti sh.A, Pejë;
13. Kompania Rajonale e Mbeturave Pastërtia sh.A, Ferizaj;
14. Kompania Rajonale e Mbeturave Eco-Regjioni sh.A, Prizren;
15. Kompania Rajonale e Mbeturave Higjiena sh.A, Gjilan;
16. Kompania Rajonale e Mbeturave Uniteti sh.A, Mitrovicë;
17. Hortikultura sh.a -Prishtinë, Prishtina 100%;
18. Sport-Marketing sh.a –Prishtinë, Prishtina 100%;

19. NPK Trafiku Urban sh.a -Prishtinë, Prishtina 100%;
20. Ndërmarrja Publike për Banim sh.a – Podujevë, Podujeva 100%;
21. Ndërmarrja Publike për Banim sh.a – Pejë, Pejë 100%.

Stacionet e Autobusëve:

1. Stacioni i Autobusëve Prishtinë, Prishtina 100%.
2. Stacioni i Autobusëve Podujevë, Podujeva 100%.
3. Stacioni i Autobusëve Fushë-Kosovë, Fushë-Kosova 100%.
4. Stacioni i Autobusëve Glllogoc, Glllogoci 100%.
5. Stacioni i Autobusëve Lipjan, Lipjani 100%.
6. Stacioni i Autobusëve Prizren, Prizreni 100%.
7. Stacioni i Autobusëve Dragash, Dragashi 100%.
8. Stacioni i Autobusëve Malishevë, Malisheva 100%.
9. Stacioni i Autobusëve Suharekë, Suhareka 100%.
10. Stacioni i Autobusëve Mitrovicë, Mitrovica 100%.
11. Stacioni i Autobusëve Vushtrri, Vushtrria 100%.
12. Stacioni i Autobusëve Leposaviq, Leposaviqi 100%.
13. Stacioni i Autobusëve Zubin Potok, Zubin Potoku 100%.
14. Stacioni i Autobusëve Zveçan, Zveçani 100%.
15. Stacioni i Autobusëve Gjilan, Gjilani 100%.
16. Stacioni i Autobusëve Viti, Vitia 100%.
17. Stacioni i Autobusëve Ferizaj, Ferizaj 100%.
18. Stacioni i Autobusëve Kaçanik, Kaçaniku 100%.
19. Stacioni i Autobusëve Pejë, Peja 100%.
20. Stacioni i Autobusëve Istog, Istogu 100%.
21. Stacioni i Autobusëve Deçan, Deçani 100%.

22. Stacioni i Autobusëve Gjakovë, Gjakova 100%.

23. Stacioni i Autobusëve Rahovec, Rahoveci 100%.

Neni 24
Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-111
20 prill 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-017-2012, datë 17.05.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.